

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                |
|---------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | "Më ka thyer krahun dhe ka abuzuar"/ Ish gruaja e dajës së Zegjine Çausshit: Nuk më ka lënë të takoj djal in prej dy vitesh... |
| ADRESA  | https://dosja.al/aktualitet/me-ka-thyer-krahun-dhe-ka-abuzuar-ish-gruaja-e-dajes-se-zegj-ine-aushi-i514810                     |
| BURIMI  | dosja.al                                                                                                                       |
| GJENDJA | online                                                                                                                         |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 18 shtator 2026, 11:02:27 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 10:42:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | ecc2a9f55f36cde3c53067fcfc5a564a1734249e35ccf921ebdb87d80a659df7 |
| TEKSTI     | ec9a2da6ab17d7d086dce645303dcbcef3fc678aa95461b5ad5e676ec0b7ab45 |
| PAMJA      | 84175fd5af7da86ba9fc1f43d77af1b75ded139afa04c4c40ca06ecbe8be4a61 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 73bbbbdc559ff35d0779b54c4f97f83ad966f89d350c0cdb07ffd8ad61c5e6ca                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 5f16ab6556ceb0058bf60cb7198a73729e9daa0d09a0a505b3785d533f275135                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/73bbbbdc559ff35d0779b54c4f97f83ad966f89d350c0cdb07ffd8ad61c5e6ca>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





LIVE UPDATES

47 MINUTA ME PARE

Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë

3 ORE ME PARE

"Protestat ndaj qeverisë janë demokraci"/ Rama: Gjykata Kushtetuese nuk i dikton Kuvendit si të votojë, të kërkojë rritje sa herë rriten pagat e të tjerëve është lajthitje

16 ORE ME PARE

110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mbledhën sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

22 ORE ME PARE

Vendimi i Hagës nxiti protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledhë Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

Aktualitet

# "Më ka thyer krahun dhe ka abuzuar"/ Ish gruaja e dajës së Zegjine Çaushit: Nuk më ka lënë të takoj djalin prej dy vitesh...

Ajo thotë se me Bakajn ka jetuar për rreth 10 vite, por është ndarë për shkak të dhunës së vazhdueshme.



18 Shtator 2026, 12:42  
Nga E.d



Bledar Bakaj

**TIRANA-** Ish-bashkëshortja e Bledar Bakajt, dajës së Zegjine Çaushit, i akuzuar se ka abuzuar me ish bashkëjetuesen Merita Gremaj ka rrëfyer situatën e saj me të akuzuarin. Gjatë një interviste për emisionin "Me zemër të hapur" të autores dhe moderatores Evis Ahmeti, ajo ka deklaruar se gjatë martesës ka përjetuar dhunë fizike, psikologjike dhe seksuale.

Më tej ajo rrëfen se nga kjo martesë kanë edhe një djalë, të cilin ish-bashkëshorti nuk e ka lejuar ta takojë. Ajo thotë se me Bakajn ka jetuar për rreth 10 vite, por është ndarë për shkak të dhunës së vazhdueshme. Ish-bashkëshortja rrëfen se daja i deputetes socialiste, i ka thyer hundën dhe krahun, ndërsa shton se këtë rast e ka denoncuar njëherë në polici.

## INTERVISTA:

Anila Ahmataj: Përshëndetje, si je?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Faleminderit, si kaluat?

Anila Ahmataj: Mirë. Ndjesë për shqetësimin, Anila jam, siç tu prezantova kur të shkruajta.

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Po.

Anila Ahmataj: Ti ke ardhur në Shqipëri sot apo jo?

## editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet  
kërkuar tek revolta e  
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

## Në vëmendje

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 10:36

"O Hashim ti ku je, UÇK-në këtu e ke"/ Shkuan në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, 50 veteranët mbërrijnë në Portin e Durrësit (VIDEO)

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 09:22

Analiza: Çfarë mund të ndodhë me shtatë figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Po, po.

Anila Ahmataj: Ke pasur kontakt këto orë që je kthyer me djalin? Ke mundur të flasësh me kunatën?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Nuk kisha numër kontakti, u mundova me njërin t'i dërgoj një numër telefoni se kam një teze në atë krahë. Edhe tha do mundohem që ta dërgoj deri në darkë.

Anila Ahmataj: Po djali ku jeton? Ke informacion ku është djali, ku ndodhet?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Halla e tij, ka një hallë atje në fshat.

Anila Ahmataj: Ti si e mësove ngjarjen?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: E mësova nga televizori, nga lajmet. Doli. Ajo më tregoi burri që kam aktualisht. Më tha mua "Çfarë është ky Bledari?". Shikoj videon edhe u shokova.

Anila Ahmataj: E njeh ti bashkëjetuesen e ish-burrit?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Vetëm se e kam parë kështu në këto videot, por nuk e njoh nga afër

Anila Ahmataj: Po ti nuk e dije që ai kishte ndërtuar një marrëdhënie tjetër, sepse aktualisht jetonte djali me të dhe ti duhet të ishe e informuar për këtë gjë, apo jo?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Jo nuk e dija se unë kam dy vite e gjysmë që ai nuk më lejon që të flas me djalin. Më merre, vetëm dërgonte budallallëqe dhe nuk kisha kontakt me një fjalë që të merrsha vesh.

Anila Ahmataj: Juve keni jetuar, me sa di unë, 9 vite me të, apo jo?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Nëntë e gjysmë, 10 fare.

Anila Ahmataj: Gati 10 vite. Dhe ke ikur vetë, apo jo?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Po, po.

Anila Ahmataj: Po si e ke njohur Bledarin?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Bledarin e kam njohur nga një vajzë e hallës time. E kishte dajën e burrit.

Anila Ahmataj: Ka pasur dhe martesë tjetër para teje?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Po, po.

Anila Ahmataj: E dije ti këtë?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Nuk e dija, e mora vesh shumë vonë. Nuk e di, katër a pesë të tjera më parë.

Anila Ahmataj: Po mbesën e tij, Zeqinenë, e ke takuar? E njeh ti këtë?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: E kam njohur më përpara, po që kur jam ndarë, jo, s'jam takuar më.

Anila Ahmataj: Marrëdhënia e saj me juve si ishte kur ju ishit bashkë në një familje? Pra, kur ishe e martuar me Bledarin?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Marrëdhënia ishte shumë e mirë me ato, po më mbas, kur kam ikur unë, kam komunikuar vetëm një herë që i kërkoja unë për gjërat e djalit, se doja ta festoja ditëlindjen e djalit nga ana ime, dhe më ka ndihmuar, që ka marrë një valixhe rroba në Roskovec edhe i ka dërguar gjërat e djalit nga ana ime, por jo në emër timin, në emër të dikujt tjetër se nuk i pranonte zotëria. E pastaj i shkëputëm kontaktet se kish pësuar probleme dhe ai i kish marrë vesh, nuk e di.

Anila Ahmataj: Pra në njëfarë forme Zeqineja ka bashkëpunuar me ty për të ndihmuar.

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Po. Po.

Anila Ahmataj: E kuptova. Po arsyeja që ju u ndatë me Bledarin cila ishte? Akuzat që të bënte ai apo dhuna?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Të gjitha bashkë, akuzat, dhuna, përdhunimin o po të gjitha gjërat.

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 07:21

Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë

më të klikuarat

Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete

Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin e famshëm 'Marbella'/ Kapen 2.7 ton kokainë, sekuestrohen dy armë zjarri dhe 29 mjete luksoze, 15 persona të arrestuar (VIDEO)

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamenti Europian i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditë Latinopoulou

Gjykata Speciale e dënoi me 25 vite burg/ Reagon Thaçi: Mirënjohje popullit të Kosovës për mbështetjen, do ta apelojmë vendimin e Hagës

insights

Auron Janku Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow

Anila Ahmataj: Po kur ju dëgjuat rrëfimin e kësaj vajzës tjetër që ndodhi me Bledarin, ajo ngjarja, çfarë menduat? Si e perceptuat ngjarjen? E besuat besoj, apo jo?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Po, dramatike. Vërtet më ka ardhur shumë keq se e kisha kaluar vetë edhe thashë "O Zot, çfarë po bëhet?".

Anila Ahmataj: E beson ti Elona që ai e ka mbajtur peng 40 ditë?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Po, po, se i kam vuajtur vetë.

Anila Ahmataj: Po familjarët e tij si kanë reaguar kur ju keni qenë së bashku dhe a ke pasur ti kontakt pas kësaj ngjarje me ndonjë nga familjarët përveç hallës, kunatës tënde?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Jo, me asnjë. Vetëm me Zeqinenë atëherë. Se më tha vetë: "Mos më ngatërro më me të se ne nuk merremi më me të se ai ti e di vetë se qysh është ai". Dhe më ka hequr nga Facebook-u dhe Messenger-i dhe e hoqa pastaj.

Anila Ahmataj: E kuptoj. Po familjarëve të tu kur ka ndodhur me ty përdhunimi, ju ke treguar? Kanë qenë në dijeni ata?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Jo, nuk u kam treguar për frikë se të njëjtat gjëra që bënte me atë, bënte edhe me mua. Kisha shumë frikë.

Anila Ahmataj: Djalin pse e mbajti babai? Pse nuk e morët ju?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Nga dhuna që më bëri mua ai.

Anila Ahmataj: Ti ia ke dhënë firmën me gjykatë?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Po, pra, ja dhashë se isha në një situatë të vështirë që isha mes vdekjes dhe nuk e mendoja se do jetoja më. Ja hoqa shpresat vetes.

Anila Ahmataj: Po pse çfarë ndodhi?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: Po goditje të rënda unë i kisha në kokë. Më ka bërë, më ka çarë buzën që e kam sot që do me plastikë, unë s'kam mundësi ta operoj. Më ka thyer hundën, e kam të thyer. Dorën e kam të shtrembër që ma ka thyer ai. Shumë gjëra.

Anila Ahmataj: Po si ka mundësi që nuk e ke denoncuar, Elona, gjatë kësaj kohe që ka ndodhur kjo dhunë sistematike ndaj teje dhe kaq brutale?

Ish Gruaja e Bledar Bakaj: E kam denoncuar vetëm një herë dhe pastaj u morëm vesh te dera, ai tha nuk e bëj më, do vazhdojmë, nuk do pij më alkool, asnjëgjë. Edhe pastaj më mbrapa e vazhdoi prapë. Ai edhe kur të dhunonte, të kyçte brenda dhe thoshte, se telefon s'kisha unë, këtë do me thënë te njerëzit e mi, ai telefon s'të linte. A se të lajmëroja policinë. Dhe më thoshte që "e ke varrin këtu". "Këtu e ke varrin. O këtu brenda në dhomë tënde," thoshte, "që sa herë të bësh vitin të çoj unë buqeta me lule këtu, ose këtu në mes të oborrin, që të të kem para syve," thoshte.

Anila Ahmataj: E tmerrshme. Ke pasur ndonjëherë frikë gjatë natës kur ti ndaje shtratin me të? Ke tentuar ndonjëherë të largohesh nga shtëpia fshehurazi?[\[Dosja.al\]](#)

bledar bakaj

## Sondazh

Poll

Aktualitet  
18 Shtator 2026, 12:28

## SKANDALI me Postën e Durrësit/ Ish-drejtoresha vodhi 700 mijë euro, bashkëshorti i saj emërohet përgjegjës për Evadimin e Mbetjeve

DURRËS- Skandali me rastit e postës së Durrësit, i cili u zbulua pak kohë më parë vijojn të ndiqet nga skandale të...

Përfshihet nga flakët një automjet në një parkim nëntokësor në Fier, policia nis hetimet

Aktualitet  
18 Shtator 2026, 12:16

Takimi sekret në Buenos Aires/ Mediat urugaiane: DEA paralajmëron përparimin e mafies shqiptare në rajon

Aktualitet  
18 Shtator 2026, 11:54

Protesta në Prishtinë/ Ambasada amerikane: Shmangni sheshin "Skënderbeu"

Aktualitet  
18 Shtator 2026, 11:44

Ndizen tensionet në Prishtinë pak para nisjes së protestës/ Policia kërkon dokumentet e identifikimit të pjesëmarrësve, qytetarët kundërshtojnë (VIDEO)

Aktualitet  
18 Shtator 2026, 11:35

Aktualitet

18 Shtator 2026, 10:57

## Plagosja e avokatit në mes të lokalit/ Dhoma e Avokatisë Durrës bojkoton për dy orë seancat gjyqësore: Kërkojmë hetim të plotë të rastit dhe rritje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.